



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR



Nr. 13 prot.

Çorovodë më: 22.04.2026

**Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Skrapar**

**Të nderuar Këshilltarë,**

Ju njoftoj se ditën e martë më datë 28.04.2026, ora 10:00<sup>00</sup>, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Skrapar, Qendra Kulturore "Riza Cerova" Kati i Dytë, zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Skrapar, e thirrur nga Kryetare e Këshillit në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 53, pikë 4, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.03.2026 dhe 31.03.2026.
3. Deklarimet e konfliktit të interesave.
4. Projekt vendim "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Mars 2026".
5. Projekt vendim "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e Bashkisë Skrapar për muajin Mars 2026".
6. Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Drita Qafaku".
7. Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Përparim Qafoku".
8. Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Eljona Jaupllari".
9. Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Besnik Ylli".
10. Të ndryshme.

Komisionet do te mblidhen si me poshte:

Komisioni i Ekonomisë dhe Financës do te mblidhet me datë 24.04.2026 ora 10:00.

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Elsa PETRITAJ**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'E. Petritaj', with a large, stylized flourish extending downwards and to the right.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR

Nr. 1244 prot.

Skrapar, më 22.04.2026

Lënda: Dërgojmë projekt-vendimet e Bashkisë Skrapar, për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Skrapar.

**Znj. Xheni Çela**

**SEKRETARES SË KËSHILLIT BASHKISË**

**SKRAPAR**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 53, pika 3 germa “a”, bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtimin në mbledhjen e radhës, projekt vendimet si më poshtë:

1. Projekt vendim “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Mars 2026”.
2. Projekt vendim “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e Bashkisë Skrapar për muajin Mars 2026”.
3. Projekt vendim “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Drita Qafaku”.
4. Projekt vendim “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Përparim Qafoku”.
5. Projekt vendim “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Eljona Jaupllari”.
6. Projekt vendim “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Besnik Ylli”.

Konfirmoi:  
Drejtoresh Juridike  
Rudina Llango

**KRYETARI  
ADRIATIK MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI SHËRBIMIT SOCIAL**

Skrapar, më 17/04/2026

**PROJEKT – VENDIM**

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDET E BASHKISË SKRAPAR  
PËR MUAJIN MARS 2026”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendim me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”

Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK-së:

**PROPOZON**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

- Mbi miratimin e Ndihmës Ekonomike nga fondet e Bashkisë Skrapar për muajin **Mars 2026**, përfitojnë **5 familje** me një fond prej **17,425 lekë** nga këto 0 familje përfitojnë kompesimin e energjisë elektrike me fond **0** lekë.
- Fondi gjithsej i shpenzuar është **17,425** lekë.
- Familjet përfituese sipas listës bashkëlidhur.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI  
ADRIATIK MEMA**



Përgjegjëse NE dhe PAK-së  
Teuta HYSNBELLIU

Drejtoria Juridike/ Burimeve Njerëzore  
Rudina LLANGO

Lista e familjeve perfituese nga fondet e bashkisë

MARS 2026

Nr.	Emer	Atesia	Mbiemer	Emer	Atesia	Mbiemer	Antare	LL.Nd	Komp. Energjie	SHUMA	Nj. Adm
1	Brunilda	Selman	Rushanji	Brunilda	Selman	Rushanji	2	3049	0	3049	Potom
2	Feta	Rraman	Terpollari	Shqiponja	Njazai	Terpollari	2	3703	0	3703	Potom
3	Dashuri	Myfit	Duçellari	Dashuri	Myfit	Duçellari	1	2178	0	2178	Bogove
4	Astrit	Nazmi	Xhaja	Meto	Dido	Xhaja	2	3703	0	3703	Bogovë
5	Bujar	Rexhep	Jaupi	Matilda	Teki	Jaupi	3	4792	0	4792	Leshnje
	<b>SHUMA</b>							<b>17425</b>		<b>17425</b>	

Përgjegjëse e NE-së dhe PAK-së  
Teuta HYSENBELLIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Skrapar, 17/04/2026

PROJEKT – VENDIM

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR 6% PËR  
MUAJIN MARS 2026”**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 30/1 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe Udhezimit nr. 3, date 17.02.2017 i ndryshuar, VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike. Udhëzimi nr. 10, datë 26.09.2006, si dhe VKM nr.8, datë 14.05.2015 “Për kompesimin e faturës së energjisë elektrike për heqjen e fashës deri në 300 KËH si dhe bazuar në kriteret e **VKB Nr. 6 datë 28.01.2026** “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe PAK-së:

**PROPOZON**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

1. Mbi miratimin e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin **Mars 2026** përfitojnë **31 familje** me një fond prej **98,210** lekë nga këto **9 famlje** përfitojnë kompesimin e energjisë elektrike me fond **11,592** lekë.
2. Fondi gjithsej i shpenzuar për muajin **Mars 2026** është **109,802** lekë.
3. Familjet përfituese sipas listës bashkëlidhur.
4. Nivelet e pagesës të jenë bazuar në V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, si dhe Udhezimit nr. 3, date 17.02.2017, i ndryshuar.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI  
ADRIATIK MEMA**

Përgjegjëse NE dhe PAK-së  
Teuta HYSNBELLI

Drejtorja Juridike/ Burimeve Njerëzore  
Rudina LLANGO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

Për muajin **Mars 2026** kanë përfituar Ndhimë Ekonomike **256 familje** me fond **1,839,732** lekë nga këto 3 individë janë me status të veçantë: 2 persona me statusin e jetimit dhe 1 familje 3-njakë.

**Fondi 6% përfitues për t'u përdorur për muajin Mars 2026 është 110,384**

*3 familje nuk janë përfituese nga sistemi i ndihmës ekonomike për arsyet e mëposhtme:*

- 1 familje, ndarje abuzive

Ardian Qemal Zenillari – Nj.Ad. Qëndër

- 1 familje, mos deklarim page

Entil Flamur Hysi – Nj.Ad. Zhepë

Që të jenë pjesë e listës së përfituesve të fondit të kushtëzuar deri në 6% duhet që familjet të mos jenë të penalizuara, por të mos kenë marrë pikët e mjaftueshme.

**PËRGJEGJËSE NE-së dhe PAK-së  
TEUTA HYSENBELLIU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Skrapar, më 21/04//2026

PROJEKT – VENDIM

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR  
SHTETASEN DRITA QAFOKU**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendim me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj’ për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasen **Drita Qafoku**, Kryetari I Bashkisë:

PROPOZON

- Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50-000 (pesëdhjete mijë) lekë, për shtetasen Drita Qafoku.
- Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administratë, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

*Ju faleminderit!*

KRYETARI  
ADRIATIK MEMA

Përgjegjëse NE dhe PAK-së  
Teuta HYSENBELLIU

Drejtorja Juridike/ Burimeve Njerezore  
Rudina LLANGO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASIN DRITA QAFOKU  
BANORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDËR, BASHKIA SKRAPAR**

Sektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasja **Drita Qafoku** më datë **30.03.2026**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë me ”, me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj’ për vitin 2026

**JU RELATOJ:**

Familja e shtetases Drita Qafoku me leje banimi në fshatin Vërzhezhë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar, përbëhet prej dy antarësh.

Znj. Drita prej disa kohësh ka shfaqur probleme të theksuara shëndetësore. Sipas dokumentacionit mjekësor është diagnostifikuar Karcinomë Skuamoze Qelizore në rajonin anorektal, një patologji e rëndë që kërkon ndërhyrje kirurgjikale të specializuar dhe trajtim të mëtejshëm me kimeo-terapi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas rekomandimeve mjekësore, ndërhyrja dhe trajtimi janë jetikë për përmirësimin e gjëndjes shëndetësore të cilat kanë dhe kosto të konsiderueshme financiare të papërbalueshme për familjen e saj.

Nga vlersimi i gjëndjes Socio-ekonomike rezulton se shtetasja përfiton vetëm pension pleqërie si burim të ardhurash. Bashkëshorti i saj gjithashtu pensionist, paraqet probleme shëndetësore, pasi ka kryer ndërhyrje kirurgjikale në stomak duke e rënduar me tej situatën ekonomike të familjes. Në këto kushte, familja nuk ka mundësi për të përbaluar shpenzimet dhe jetesën në një shtet tjetër.

Duke marrë parasysh gjëndjen shëndetësore të shtetases, trajtimin e domosdoshëm mjekësor, shihet e domosdoshme dhënia e ndihmës financiare për këtë rast.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

E ndodhur në këto kushte të vështira sociale – ekonomike dhe në rrezik për shëndetin e znj. Drita Qafoku, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënien e ndihmës financiare në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënien e ndihmës financiare për familjen e znj. Drita Qafoku.

Përgjegjëse e NE-së dhe PAK-së  
Teuta Hysenbelliu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Skrapar, më 21/04//2026

PROJEKT – VENDIM

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR  
SHTETASIN PËRPARIM QAFOKU**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendim me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasin **Përparim Qafoku**, Kryetari I Bashkisë:

**PROPOZON**

- Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50 000 (pesëdhjete mijë) lekë, për shtetasin Përparim Qafoku.
- Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administratë, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI  
ADRIATIK MEMA**

Përgjegjëse NE dhe PAK-së  
Teuta HYSNBELLIU

Drejtorja Juridike/ Burimeve Njerezore  
Rudina LLANGO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASIN PËRPARIM QAFOKU  
BANORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDËR, BASHKIA SKRAPAR**

Sektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasi **Përparim Qafoku** më datë **30.03.2026**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë me ”, me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj’ për vitin 2026

**JU RELATOJ:**

Familja e shtetasit Përparim Qafoku me leje banimi në fshatin Vërzhezhë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Skrapar, përbëhet prej dy antarësh.

Z. Përparim prej disa kohësh ka shfaqur probleme të theksuara shëndetësore. Sipas dokumentacionit mjekësor vuan nga një situatë komplekse onkologjike që ka kërkuar disa ndërhyrje kirurgjikale. Është diagnostigikuaar me Adenokarcionomë gastrike, ndërhyrje me heqje të plotë të stomakut dhe më pas ka bërë ndërhyrje në mushkëri. Gjithashtu është në një fazë kritike të trajtimit post-operator dhe duhet të vijojë kontrollet dhe kimioterapinë sipas protokollit të qëndres Onkologjike në Romë.

Të dy bashkëshortët janë pensionist me të ardhura minimale, të cilat janë të pamjaftueshme për të mbuluar koston e lartë të medikamenteve onkologjike dhe dietës specifike që kërkon një person pa stomak. Bashkëshortja ka probleme të rënda shëndetësore dhe i duhet të kryejë ndërhyrje kirurgjikale dhe kimioterapi jasht shtetit shqiptar.

Sipas rekomandimeve mjekësore, kontrollet dhe trajtimi janë jetikë për përmirësimin e gjëndjes shëndetësore të cilat kanë dhe kosto të konsiderueshme financiare të papërballueshme për familjen e tij.

Duke marrë parasysh gjëndjen shëndetësore të shtetasit, trajtimin e domosdoshëm mjekësor, shihet e domosdoshme dhënia e ndihmës financiare për këtë rast.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

E ndodhur në këto kushte të vështira sociale – ekonomike dhe në rrezik për shëndetin e z.Përparim Qafoku, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënien e ndihmës financiare në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënien e ndihmës financiare për familjen e z. Përparim Qafoku.

**Përgjegjëse e NE-së dhe PAK-së**  
**Teuta Hysenbelliu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Skrapar, më 21/04//2026

PROJEKT – VENDIM

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR  
SHTETASEN ELJONA JAUPLLARI**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendim me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasen **Eljona Jaupllari**, Kryetari I Bashkisë:

**PROPOZON**

- Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50 000 (pesëdhjete mijë) lekë, për shtetasen Eljona Jaupllari.
- Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administrative, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI  
ADRIATIK MEMA**

Përgjegjëse NE dhe PAK-së  
Teuta HYSNBELLIU

Drejtorja Juridike/ Burimeve Njerezore  
Rudina LLANGO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASEN ELJONA JAUPLLARI  
BANORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇEPAN, BASHKIA SKRAPAR**

Sektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasja **Eljona Jaupllari** më datë **20.01.2026**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë me “, me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për vitin 2026

**JU RELATOJ:**

Familja e shtetasës Eljona Jaupllari me leje banimi në fshatin Sevran, Njësia Administrative Çepan, Bashkia Skrapar, përbëhet prej dy antarësh, kryefamiljarja dhe djali.

Shtetasja është kryefamiljare e divorcuar dhe nën kujdesin e saj ka djalin adoleshent. Gjëndja e saj sociale dhe ekonomike paraqitet e vështirë pasi rezulton e papunë për shkak të problemeve shëndetësore që lidhen me shtyllën kurrizore, konkretisht me praninë e dy hernieve diskale, të cilat kufizojnë aftësinë për punë. Trajtohet me pagesë invaliditeti niveli i dytë i moderuar me vlerën 11944 ( njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e katër ), shumë e cila përbën të vetmin burim të ardhurash për familjen. Familja jeton me qira në qytetin e Çorovodës duke rënduar më tej situatën e saj ekonomike dhe mos perballimin e shpenzimeve bazë të jetesës.

Duke marrë parasysh gjëndjen shëndetësore të shtetasës trajtimin e domosdoshëm mjekësor, shihet e domosdoshme dhënia e ndihmës financiare për këtë rast.

E ndodhur në këto kushte të vështira sociale – ekonomike dhe në rrezik për shëndetin e znj. Eljona Jaupllari, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për familjen e znj.Eljona Jaupllari.

**Përgjegjëse e NE-së dhe PAK-së**

**Teuta Hysenbelliu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Skrapar, më 21/04/2026

PROJEKT – VENDIM

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR  
SHTETASIN BESNIK YLLI**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendim me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasin **Besnik Ylli**, Kryetari I Bashkisë:

**PROPOZON**

- Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50 000 (pesëdhjete mijë) lekë, për shtetasin Besnik Ylli.
- Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri shpenzime operative administratë, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

*Ju faleminderit!*

**KRYETARI  
ADRIATIK MEMA**

Përgjegjëse NE dhe PAK-së  
Teuta HYSNBELLIU

Drejtorja Juridike/ Burimeve Njerezore  
Rudina LLANGO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASIN BESNIK YLLI BANOR  
NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR**

Sektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasi **Besnik Ylli** më datë **21.04.2026**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë me “, me Nr.72, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit të buxhetit afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për vitin 2026

**JU RELATOJ:**

Familja e shtetasit Besnik Ylli me leje banimi në qytetin e Çorovodës, Bashkia Skrapar, përbëhet prej dy antarësh, kryefamiljari dhe bashkëshortja.

Z. Besnik Ylli ndodhet në gjëndje shëndetësore jashtëzakonisht të rënduar, pasi vuan nga insuficiencia renale kronike dhe është i deyruar t'i nënshtrohet dializës disa herë në javë në QSUT pasi ka dhe probleme të theksuar të gjakut. Ky trajtim është i lodhshëm fizikisht por dhe emocionalisht pasi sa vjen dhe gjëndja emocionale rëndohet duke kaluar në gjëndje depresive për shkak të sëmundjes.. Ndërkohë shpenzimet për transport, medikamente ndihmëse dhe analiza të shpeshta krijojnë vështërsi financiare për familjen.

Për shkak të problemeve të shumta shëndetësore, nuk ka mundësi punësimi, nuk trajtohet me pagesë paaftësie, si burim të ardhurash kanë vetëm ndihmën ekonomike me vlerë 5000 (pesë mijë) lekë në muaj.

Z. Besnik jeton me qira në qytetin e Tiranës gjë që i shton edhe më shumë vështirësitë ekonomike, çdo muaj përballet me pamundësi reale për të përballuar qiranë, ushqimet si dhe shpenzimet shtesë mjekësore që lidhen me gjëndjen e tij kritike shëndetësore

Duke marrë parasysh gjëndjen shëndetësore të shtetasit, trajtimin e domosdoshëm mjekësor, shihet e domosdoshme dhënia e ndihmës financiare për këtë rast.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

E ndodhur në këto kushte të vështira sociale – ekonomike dhe në rrezik për shëndetin e z.Besnik Ylli, Bashkia Skrapar merr përsipër dhënien e ndihmës financiare në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënien e ndihmës financiare për familjen e z. Besnik Ylli.

Përgjegjëse e NE-së dhe PAK-së  
Teuta Hysenbelliu

